

## **Takim I Nivelit Të Lartë Rreth Statusit Të Ardhshëm Të Kosovës**

### **Deklaratë e Grupit të Kontaktit (24 korrik, 2006), Vjenë**

Grupi i Kontaktit, BE-ja dhe NATO vëzhguan rethin e parë të bisedimeve direkte rreth statusit të Kosovës në Vjenë, më 24 korrik 2006, nën përkujdesjen e të Dërguarit të Posaçëm të KB Martti Ahtisaari. Presidenti Boris Tadic dhe Kryeministri Vojislav Kostunica përfaqësonin Beogradin; ndërsa Ekipi i Unitetit, i udhëhequr nga Presidenti Fatmir Sejdiu përfaqësonte Prishtinën. Takimi i sotshëm ishte një hap i rëndësishëm në procesin e zgjidhjes së kësaj çështje kyçe.

Grupi i Kontaktit ripohon përkushtimin e vetë për procesin e statusit të parashikuar me rezolutën 1244 të KSKB, Parimeve Udhëzuese dhe qëndrimin të theksuar në Deklaratën Ministrore të 31 janarit. Grupi i Kontaktit falenderon Presidentin Ahtisaari dhe ekipin e tij për përkushtimin dhe lidhshmërinë e tyre në procesin e statusit, dhe përkrah vendimin e tij për të lëvizur në këtë fazë tjetër të rëndësishme, e cila siq ne mendojmë ishte dashur të shpie kah zhvillimi i një propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit. Ne përgëzojmë të dy palët për gatishmërinë e tyre që të bisedojnë direkt për çështjen kyçe të statusit, dhe presim një angazhim konstruktiv, fleksibilitet dhe gatishmëri të të dy palëve për të arritur tek solucionet realiste të bazuara në kompromis. Ne mirëpresim vazhdimësinë, paralelisht me bisedimet rreth statusit, e negociatave për mbrojtjen e trashëgimisë së kultive fetare, decentralizimit, dhe çështjeve ekonomike, dhe theksojmë rëndësinë e zgjerimit të agjendës rreth çështjeve tjera kyçe sikurse masat për mbrojtjen e komuniteteve.

Grupi i Kontaktit lëvdëron përpjekjet e të Dërguarit të Posaçëm të KB për të gjetur (zhvilluar) propozime të cilat do të ofrojnë një bazë të fuqishme për një Kosovë demokratike dhe multietnike në të cilën do të jenë plotësisht të mbrojtura të drejtat e të gjithë qytetarëve të sajë. Është në interesin e Beogradit dhe Prishtinës që t'i dëgjojnë vëmendshëm propozimet e njëri tjetrit dhe të gjejnë zgjidhje realiste të pranueshme për të dy palët. Në këtë kontekst, Grupi i Kontaktit e ndan qëndrimin me Presidentin Ahtisari se të dy palët duhet të bëjnë më shumë në të gjitha aspektet e procesit në mënyrë që të përmbushet ky qëllim.

Grupi i Kontaktit vëren që Prishtina ka treguar fleksibilitet në bisedimet rreth decentralizimit. Megjithatë, Prishtina duhet të jetë e gatshme të ofrojë edhe më shumë për shumë çështje tjera para se procesi i statusit të mund të sjell tek përfundimi i suksesshëm. Ne gjithashtu theksojmë nevojën për progress të mëtutjeshëm në implementimin e standardeve.

Beogradi duhet të demonstroj shumë më shumë fleksibilitet në bisedime se që ka bërë gjer më tani. Beogradi duhet të filloj të konsideroj kompromiset e arsyeshme dhe të realizueshme për shumë çështje që janë duke u diskutuar, posaçërisht rreth

decentralizimit. Grupi i Kontaktit e përsërit thirrjen e vetë drejtuar Beogradit që të ndërpresë obstrukcionin rreth participimit të Serbëve të Kosovës në institucionet e Kosovës, në të cilat Serbët e Kosovës në mënyrën më efektive do të mund ti advokonin (mbrojnë) interesat e tyre; të anulon direktivën rreth të ardhurave për Serbët e Kosovës; dhe të dorëzon shënimet kadastrale.

Njëra nga qëllimet kryesore të bashkësisë ndërkombëtare është që në Kosovë të krijon kushte ku të gjitha komunitetet do të mund të jetonin në një shoqëri multietnike. Në mënyrë që të mundësohet krijimi i kushteve të tilla, e rëndësishme kyçe është përkrahja e plotë e Serbisë. Grupi i Kontaktit me brengosje e vëren situatën në veriun e Kosovës, posaçërisht hapin e tri komunave për t'i ndërprerë lidhjet me Institucionet e Përkohshme Vetë-qeverisëse (IPVQ), si dhe raportet për shtimin e personelit në strukturat ilegale dhe paralele të sigurisë. Ne ftojmë të dy komunitetet që të ushtrojnë vetëpërmbytje dhe mirëkuptim të dyanshëm në këtë periudhë të ndjeshme (delikate) të negociatave dhe të bashkëpunojnë plotësisht me UNMIK-un, KFOR-in dhe Shërbimin Policor të Kosovës (SHPK) në punën e tyre për të ofruar një ambient të sigurtë në të gjitha pjesët e Kosovës. Në këtë kontekst, ne mirëpresim pozicionimin shtesë të trupave të NATO-së në Kosovën veriore. Nuk do të ketë ndarje të Kosovës apo cfarëdo ujdi të tjera që do të krijojnë ndarje të reja.

Grupi i Kontaktit ripohon se duhet bërë të gjitha përpjekjet e mundshme për të arritur një zgjidhje të negociueshme gjatë vitit 2006 e cila, ndër të tjera, është e pranueshme për popullin e Kosovës dhe e cila do të nxit një shoqëri multietnike me një të ardhme për të gjithë qytetarët e sajë. Ashtu siq është e theksuar në Parimet Udhëzuese, sapo të fillojnë negociatat, ato nuk mund të lejohet të bllokohen. Procesi duhet shpjer drejtë përfundimit, të paktën jo duke minimizuar efektet destabilizuese politike dhe ekonomike me vazhdimësinë e paqartësisë rreth statusit të ardhshëm të Kosovës. Grupi i Kontaktit do të monitoron në një masë angazhimin konstruktiv të të dy palëve dhe do t'i nxjerr konkludimet në përputhje me rrethanat.

Ne vendosmërisht besojmë se zgjidhja e statusit të Kosovës do të shtoj stabilitetin rajonal dhe do të hapë rrugën për perspektivën Evropiane dhe Evro-Atlantike për Serbinë, Kosovën dhe rajonin në tërësi. Ne ritheksojmë gatishmërinë e bashkësisë ndërkombëtare për të vendosur struktura të përshtatshme, të miratuara nga Këshilli i Sigurimit të KB, në mënyrë që të sigurohet që në një ambient të sigurtë të bëhet implementimi dhe përmbushja e dispozitave të dala nga zgjidhja e statusit. Grupi i Kontaktit qëndron i gatshëm të asistojë me implementimin e një zyre të re ndërkombëtare e cila do të jetë përgjegjëse për përkrahjen dhe mbikëqyrjen e implementimit të zgjidhjes së statusit. Ne i mirëpresim planet fillestare që tashmë janë duke u zhvilluar në kuadër të NATO-s për kontinuitetin e prezencës ushtarake ndërkombëtare në Kosovë pas zgjidhjes së statusit. Njëjtë, ne mirëpresim aktivitetet e planifikuara që janë duke u zhvilluar në kuadër të BE-së për të përcaktuar rolin e BE-së pas zgjidhjes së statusit, posaçërisht përmes misionit të fuqishëm politik të sundimit të ligjit si dhe mjeteve praktike për të jetësuar perspektivën Evropiane për Kosovën.